



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glogoc
Zyra e Personelit
01Nr. AAA-6448 dt. 30.07/2019

Bazuar në nenin 12 ,paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Glogoc/Drenas, U.D. Udhëheqëse e Personelit shpall:

KONKURS PUBLIK
Të Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Titulli i vendit të punës:
2 (dy) Zyrtar për Shërbime Sociale 2

koefficienti:
5

Përshkrimi i vendit të punës:

1. Ofron shërbime në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësim, strehim;
2. Bën mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikvente;
3. Ndihmon rastet e abuzimit dhe lënies pas dore të fëmijëve;
4. Punon në sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare;
5. Trajton rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit me qenie njerëzore;
6. Punon në mbrojtjen e të moshuarve dhe bën mbrojtjen e tyre dhe strehim;
7. Mban dosjet e lëndëve dhe dokumentacionin, si dhe futja e lëndëve në bazën e të dhënave;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor, (aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):
Diplomë universitare;

Fakulteti Filozofik- Drejtimi Sociologji, Psikologji, Punëtor Social, Fakulteti Juridik

Njohje kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin;

Aftësia për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;

Njohuri substanciale në lëminë e shërbimeve sociale;

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.


Konkursi mbetet i hapur shtatë (7) ditë kalendarike, nga dita e publikimit nga 01/08/2019 deri më 07/08/2019, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këto vende të punës, për të cilat konkurohet.



Udhëheqëse e Personelit

Hamit Shabani